



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 189 prot.

Kamëz, më 21.12.2022

V E N D I M
Nr. 182 .Datë 21/12 2022
M B I

“MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN “PËRMIRËSIMI I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETE TË VARFRA DHE TË PA FAVORIZUARA” PËR VITIN 2023”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 21.12.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.144 Datë 19.12.2022 në zbatim të pikës 2, të nenit 24, germa "k" e nenit 54, të Ligjit Nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", referuar Ligjit Nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", VKM nr. 384, datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore ", VKM nr. 454, datë 3.7.2019, "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", VKM nr. 458, datë 3.7.2019, VKM nr. 823, datë 18.12.2019 ,Udhëzimit të Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 31, datë 18.11.2019 "Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit", shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë " me nr.Prot.1237 dt.24.01.2022 Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e sistemit të pikëzimit për trajtimin sipas programit strehimit social *“Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara”*.
2. Mënyrën e vlerësimit dhe llogaritjes sipas Aneksit nr.1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të ngarkojë Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Sektorin e Strehimit Social për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI